



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_ / \_\_\_\_ /2018

**V E N D I M**

**Nr. 58 , Datë 13 / 2 / 2018**

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën Nr. nr. 136, datë 24.10.2017, të paraqitur nga subjekti ankues E.S<sup>1</sup> kundër Drejtorisë Arsimore Rajonale Vlorë dhe Drejtorisë së Shkollës 9-vjeçare “24 Maji”, në të cilën pretendohet diskriminim për shkak të “aftësisë së kufizuar” të djalit të saj të diagnostikuar me “Çrregullim Autik”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

**K O N S T A T O I:**

E.S informon se, djali i saj mëson në klasën e II-të në shkollën 9-vjeçare “24 Maji”, Vlorë. Me vendim të Komisionit Multidisiplinar të DAR Vlorë, është vendosur që fëmija të asistohet në klasë nga një mësues ndihmës. Në klasën e parë, nga ana e shkollës është caktuar një mësuese ndihmëse, me arsim të profilit të pedagogjisë së specializuar sociale, me të cilën djali i ankueses është përshtatur dhe ka patur ecuri mësimore të kënaqshme. Pasi fëmija ka nisur klasën e II-të, nga ana e shkollës i është caktuar një tjetër mësuese ndihmëse, L.B, e cila ka ndjekur një nxënës tjetër të së njëjtës shkollë. Pas kërkesave të prindërve të këtij nxënësi dhe pasi L.B u shfaq në media në një nga emisionet investigative, e larguan nga nxënësi që kishte dhe e caktuan si mësuese ndihmëse të djalit të ankueses. Sipas ankueses, L.B jo vetëm që nuk ka arritur të përshtatej me djalin e saj, por nuk disponon as kualifikimet e duhura për të qënë mësuese ndihmëse pranë nxënësve me aftësi të kufizuara.

Në këto kushte, ankuesja nuk e dërgon në mësim të birin, deri në momentin që nga ana e shkollës dhe DAR Vlorë, të caktohet një mësues ndihmës i specializuar për ta asistuar atë.

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore,*

<sup>1</sup> Në cilësinë e prindit të fëmijës L.M.

*gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.*

Diskriminimi për shkak të aftësisë së kufizuar është shkak i mbrojtura nga ligji nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, dhe bazuar në nenin 32/1/c të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këtë shkak.

Bazuar në nenin 7 të ligjit nr. 10221/2010, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprim të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

### **Për sa më sipër, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ndërmoi hapat proceduralë si më poshtë vijojnë :**

Pas analizimit të ankesës, u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33, pika 3 të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”. Për këtë arsye, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.

1. Referuar Urdhërit nr. 148, datë 25.10.2017 të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi “Për kryerjen e inspektimit në Drejtorinë Arsimore Rajonale Vlorë dhe në Shkollën 9-vjeçare ‘24 Maji’, Vlorë”, ekipi i inspektimit të KMD-së, në datën 26.10.2017, kreu inspektim pranë Drejtorisë Arsimore Rajonale Vlorë dhe Shkollës 9-vjeçare “24 Maji”, Vlorë.

Objekti i inspektimit konsistonte kryesisht në çështjet e mëposhtme :

- Informacion mbi Vendimin e Komisionit Multidisiplinar, të krijuar pranë DAR Vlorë, mbi nxënësin L.M.
- Informacion lidhur me masat e marra nga DAR Vlorë, për caktimin e një mësuesi ndihmës për nxënësin L.M.
- Kopje të procedurave dhe të vendimit të emërimit për mësueset, E.C për vitin shkollor 2016-2017 dhe mësuesen L.B për vitet shkollore 2016-2017 dhe këtë vit shkollor.
- Kopje të diplomës dhe kualifikimeve për mësueset: E.C dhe L.B.
- Marrja e informacionit, të drejtpërdrejtë nga drejtori i shkollës dhe psikologu i shkollës lidhur me ecurinë e nxënësit.
- Verifikimin e vlerësimit përshkrues të nxënësit nga mësuesja dhe psikologu i shkollës (kopje të dosjes).

Për të kryer verifikimet e nevojshme, inspektorët e KMD-së u paraqitën fillimisht pranë DAR Vlorë, ku u takuan me A.S, me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Programim Zhvillimi. Nga informacioni i marrë rezultoi se me fillimin e vitit shkollor 2017-2018, Komisioni Multidisiplinar, pas vlerësimit rast pas rasti të nxënësve me aftësi të kufizuara, kishte urdhëruar drejtorinë e shkollës “24 Maji” të bënte menjëherë caktimin e mësuesëve mbështetës për tre nxënës të kësaj shkolle, përkatësisht për nxënësit Sh.S, L.M dhe E.Gj me një ngarkesë mësimore 24 orë në javë. Lidhur me punësimin e mësuesve ndihmës, A.S sqaroi se, fillimisht ishin shpallur vendet e lira të punës në faqen e web-it të DAR Vlorë, si dhe janë njoftuar të gjithë mësuesit që kishin përfunduar pedagogjinë speciale, të drejtoheshin në shkollat respektive ku ishte i nevojshëm punësimi i mësuesve ndihmës. Më pas, sipas nevojave janë emëruar në shkollat ku ishin vendet vakante për punësimin e mësuesve ndihmës.

Shkolla “24 Maji”, frekuentohej nga tri nxënës, të cilëve duhet t’u caktohej mësues ndihmës. Gjatë vitit shkollor 2015-2016, prindërit e nxënëses Sh.S, ishin ankuar lidhur me mësuesen ndihmëse të fëmijës së tyre, E.C dhe në këto kushte në vitin pasardhës 2016-2017, drejtoria e shkollës “24 Maji”, kishte zëvendësuar atë me mësuesen L.B. Në fund të vitit shkollor 2016-2017, përsëri prindërit e nxënëses Sh.S, kishin shprehur pakënaqësi kundrejt mësueses L.B.

Gjatë inspektimit të zhvilluar në Shkollën 9-vjeçare “24 Maji”, Vlorë, inspektorët e Komisionerit u takuan me Drejtor i Shkollës, me E.M, psikologe e shkollës.

Drejtori i shkolles u shpreh se pranë Shkollës 9-vjeçare “24 Maji”, Vlorë, gjatë vitit shkollor 2016-2017 dhe 2017-2018, mësonin 3 nxënës me aftësi të kufizuara të cilëve u ishte caktuar nga një mësues ndihmës sipas ngarkesës së përcaktuar nga DAR Vlorë. Gjatë vitit shkollor 2016-2017, për nxënësen Sh.S ishte caktuar mësuese ndihmëse L.B, e cila kishte kontratë pune me afat të pacaktuar me shkollën; për nxënësin L.M ishte caktuar mësuese ndihmëse E.Ç, me kontratë pune me afat një vjeçar dhe për nxënësen E.Gj, ishte caktuar mësuesja ndihmëse M.N, me kontratë pune me afat të pacaktuar. Mësueset L.B dhe M.N, janë punësuar nga DAR Vlorë, si mësuese ndihmëse në shkollën “24 Maji”, pasi u është suprimuar pozicioni i punës në shkollat respektive ku ushtronin profesionin. Mësuesja E.Ç ka filluar punë në shkollën “24 Maji” gjatë vitit shkollor 2015-2016, si mësuese ndihmëse e nxënëses Sh.S. Pas ankesave të prindërve të kësaj nxënëse, E.Ç gjatë vitit shkollor 2016-2017, është caktuar mësuese ndihmëse e nxënësit L.M. Prindërit e nxënëses Sh.S, kanë shprehur pakënaqësi edhe ndaj mësueses ndihmëse L.B, e për rrjedhojë drejtoria e shkollës “24 Maji”, në vitin shkollor pasardhës 2017-2018, e caktoi L.B mësuese ndihmëse e nxënësit L.M.

Në fillim të vitit shkollor 2017-2018, DAR Vlorë shpalli vendet vakante për mësues ndihmës, një ndër këto vende ishte edhe pozicioni i mësueses E.Ç, të cilës i kishte përfunduar kontrata 1 vjeçare e punës. Pasi u prit afati i caktuar, në shkollën “24 Maji”, kanë dorëzuar kërkesat tre mësuese ndihmëse dhe në bashkëpunim me prindërit e nxënëses Sh.S, është zgjedhur një mësuese për të. Nga R.B theksohet fakti që mësuesja E.Ç, nuk ka paraqitur dokumentacion për të konkuruar për pozicionin e mësueses ndihmëse në shkollën “24 Maji”. Në këto kushte, nxënësi L.M vijoi mësimin me mësuesen ndihmëse L.B dhe për nxënësen Sh.S, u caktua mësuesja e sapo

emëruar M.S. Me nisjen e vitit shkollor 2017-2018, nxënësi L.M, është paraqitur në shkollë nga data 11.09.2017 deri më datë 21.09.2017.

Nga informacioni i dhënë nga ana e psikologe e shkollës, nxënësi L.M, ka patur një ecure pozitive në raport me objektivat e vendosura në PEI. Edhe në fillimin e vitit shkollor 2017-2018, pas një vëzhgimi të bërë më datë 14.09.2017, nxënësi ka rezultuar të jetë përshtatur me mësuesen ndihmëse L.B, por që nga data 21.09.2017 e në vazhdim nxënësi nuk ka frekuentuar më shkollën. Në përfundim, përfaqësuesit e shkollës “24 Maji”, sqaruan se kishin kontaktuar në telefon me prindërit e nxënësit dhe kishin insistuar që ta rikthejnë në shkollë, por një gjë e tillë është refuzuar prej tyre me arsyetimin se nxënësi me mësuesen ndihmëse, L.B, ka pësuar regres dhe kanë kërkuar rikthimin e E.Ç si mësuese ndihmëse të djalit të tyre.

Në vijim, pas inspektimit të kryer pranë shkollës “24 Maji”, inspektorët e KMD-së, morën takim me prindërit e nxënësit L.M. Gjatë takimit ata u shprehën se kanë kërkuar pranë DAR Vlorë, që fëmija i tyre të vazhdojë të ketë mësuese ndihmëse E.Ç, por janë vënë në dijeni se asaj i ka mbaruar kontrata me shkollën “24 Maji”, e për rrjedhojë nuk mund të rikthehet. Në këto kushte dhe duke qënë se djali i tyre ka patur një progres me mësuesen ndihmëse E.Ç, ata kishin vendosur që fëmija të mos frekuentojë më shkollën, deri në momentin që nga ana e shkollës, t’i caktohet sërish kjo mësuese.

**Më datë 24.11.2017, Drejtoria e Shkollës 9-vjeçare “24 Maji”, Vlorë, vuri në dispozicion<sup>2</sup> të KMD-së, informacion shtesë ku evidentohet emërimi i mësueses ndihmëse, E.Ç, për nxënësin L.M.**

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga ligji nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”.

**Për sa më sipër, gjatë procesit të hetimit, pas shqyrtimit të dokumentacionit të vënë në dispozicion nga ankuesi dhe palët kundrejt së cilës drejtohej ankimi, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatoi :**

Legjislacioni shqiptar në fushën e arsimit i jep përparësi të dukshme, trajtimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara, në institucionet arsimore shqiptare.

- E drejta për arsimim është një e drejtë kushtetuese, e përcaktuar në nenin 57 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, e cila po ashtu gëzon një mbrojtje të posaçme nga Konventa e OKB-së “Për të drejtat e PAK”.
- Sipas nenit 116 të Kushtetutës, Konventa, si një marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar me ligj, në hierarkinë e normave juridike renditet menjëherë pas Kushtetutës. Për pasojë,

<sup>2</sup> Protokolluar pranë KMD-së me nr. 1068/2 prot., datë 24.11.2017

ajo zë një vend të rëndësishëm në të drejtën e brendshme e bëhet e detyrueshme për t'u zbatuar për çdo shtet, për të gjithë organet shtetërore.

- *“Konventa e OKB-së për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”*, e ratifikuar nga Shqipëria me ligjin nr. 108/2012, datë 15 Nëntor 2012, i ofron mbrojtje personave me aftësi të kufizuar, duke ndryshuar para së gjithash, trajtimin e aftësisë së kufizuar nga ai bazuar në modelin mjekësor, në trajtimin sipas modelit social. Konventa ka për qëllim të nxisë, të mbrojë dhe t'u sigurojë që të gjithë personat me aftësi të kufizuar të gëzojnë plotësisht dhe në mënyrë të barabartë të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të nxisë respektin për dinjitetin e tyre. Parimi i mosdiskriminimit është një ndër parimet e kësaj Konvente, ku ofrohet një *mbrojtje e veçantë për fëmijët me aftësi të kufizuar*, për të siguruar *që këto fëmijë të gëzojnë të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut njësoj si të gjithë fëmijët e tjerë*.

Në këtë kuadër, legjislacioni shqiptar u ngarkon detyra të rëndësishme njërive arsimore vendore (DAR/ZA) dhe drejtuesve të institucioneve arsimore, lidhur me mënyrën, se si duhen asistuar dhe krijuar kushtet e nevojshme dhe të përshtatshme në mësimdhënie për nxënësit me aftësi të kufizuara. Qëllimi kryesor i këtij legjislacioni në tërësinë e tij, është krijimi i të gjithë kushteve të nevojshme, që këta fëmijë të mund të arsimohen njëlloj si të gjithë fëmijët e tjerë, si dhe ajo që vlen të theksohet më tepër është prioriteti i këtij legjislacioni për t'i përfshirë dhe integruar ata në institucionet arsimore të zakonshme.

Nën këtë frymë konsiston edhe përmbajtja e nenit 63, pika 2 e ligjit nr. Nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, ku parashikohet: *“Përfshirja e fëmijëve me aftësi të kufizuara në institucionet arsimore të specializuara për ta është përgjithësisht e përkohshme. Përfshirja dhe integrimi i fëmijëve me aftësi të kufizuara në kopshtet dhe shkollat e zakonshme të arsimit bazë është parësore”*.

Megjithatë, për të përcaktuar saktësisht, nëse një fëmijë me aftësi të kufizuar, duhet të ndjekë një institucion arsimor të specializuar apo një shkollë të zakonshme të arsimit bazë, legjislacioni parashikon:

Në nenin 64, pika 3 i ligjit të sipërpërmendur dhe nenit 93, të Urdhërit nr. 343, datë 19.08.2013, të Ministrisë të Arsimit dhe Shkencave, parashikohet që: *Si detyrim ligjor të njësisë arsimore vendore, pra DAR-it, të krijojë një komision, të përbërë nga mjekë, psikologë, mësues dhe specialistë për fëmijët me aftësi të kufizuara, i cili, pasi shqyrton kërkesën e prindit ose të drejtorit të një institucioni arsimor, jep rekomandimet përkatëse për ndjekjen nga fëmija të një institucioni arsimor të zakonshëm a të specializuar.*

Sikurse vihet re, nga parashikimet tepër të detajuara të legjislacionit<sup>3</sup>, DAR Vlorë ka detyrime tepër të rëndësishme, lidhur me asistencën dhe kujdesin ndaj nxënësve me aftësi të kufizuar që

1. <sup>3</sup> *DAR/ZA-ja ngre komisionin multidisiplinar të përbërë nga një mjek peditër (kur është e mundur, mjek peditër zhvillimi), një psikolog, një punonjës social, një mësues (kur është e mundur, mësues i kualifikuar për arsimin e specializuar) dhe drejtuesi i njësisë së shërbimit psiko-social.*
2. *Kryetar i komisionit është drejtuesi i njësisë së shërbimit psiko-social.*

mësojnë në institucionet arsimore të qytetit të Vlorës. Mbështetur në Vendimin nr. 7, datë 09.12.2015 “Për krijimin e Komisionit Shumëdisiplinor për Trajtimin e nxënësve me aftësi të kufizuara” dhe provat e administruara DAR Vlorë kishte ngritur Komisionin Multidisiplinor dhe kishte vlerësuar nxënësin L.M.

Nga ana tjetër, neni 65, pika 2, të ligjit nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë” parashikon: “Në institucionet arsimore të zakonshme, programi i personalizuar për nxënësin me aftësi të kufizuara hartohet nga një komision, në përbërje të të cilit janë mësues të fushave të ndryshme të të nxënës të institucionit e psikologë. Hartimi i këtij programi bëhet në bashkëpunim me prindërit e nxënësit. Ndryshimi i programit të personalizuar brenda një institucioni arsimor vendoset nga komisioni brenda institucionit, në bashkëpunim me prindërit e fëmijës”. Gjithashtu, Urdhëri nr. 343, datë 19.8.2013, i Ministrit të Arsimit dhe Shkencave “Për miratimin e dispozitave normative për sistemin arsimor parauniversitar”, në pikën 1 të Nenit 95, parashikon shprehimisht: “1. Drejtori i institucionit arsimor të zakonshëm ngre komisionin për nxënësit me AK, në përbërje të të cilit janë tre mësues të lëndëve të fushave të ndryshme të të nxënës dhe psikologu/punonjësi social.”

Pra, ngritja e një komisioni të tillë është detyrim konkret për drejtuesit e institucioneve arsimore të zakonshme. Bazuar në dokumentacionin e sjellë nga ana e shkollës pranë Komisionerit, ky detyrim është përmbushur nga ana e shkollës 9-vjeçare “24 Maji” për vitin shkollor 2017-2018, pasi, është ngritur Komisioni i vlerësimit të nxënësve me aftësi të kufizuara pranë shkollës, si dhe është hartuar PEI me të cilin është punuar me nxënësin L.M. Referuar dokumentacionit të

3. Komisioni, me kërkesën e prindit të fëmijës ose të drejtorit të institucionit arsimor, ku fëmija është regjistruar, vlerëson nevojat arsimore e shoqërore të fëmijës dhe ecurinë e tij. Komisioni mbledhet 3 herë në vit, para fillimit të vitit shkollor, në fund të semestrit të parë dhe në fund të vitit mësimor.
4. Drejtori i institucionit arsimor këshillohet me komisionin e institucionit arsimor para se t'i drejtohet komisionit pranë DAR/ZA-së dhe bashkëpunon me prindërit e fëmijës për të paraqitur kërkesën e tij.
5. Prindi i paraqet komisionit pranë DAR/ZA-së raportin vlerësues të fëmijës së tij të kryer nga Komisioni Mjekësor i Caktimit të Aftësisë për Punë, kur fëmija është vlerësuar nga ky komision mjekësor.
6. Komisioni:
  - a) njofton prindin për gjendjen dhe ecurinë e fëmijës;
  - b) i jep me shkrim personit që ka paraqitur kërkesën, rekomandimin për ndjekjen nga fëmija të shkollës së zakonshme ose të specializuar ose kalimin nga shkolla e specializuar në shkollën e zakonshme apo anasjelltas;
  - c) sugjeron kopshtin/shkollën me kushtet më të përshtatshme për nxënësin;
  - d) rekomandon shërbimet shtesë që duhet të marrë fëmija në qendra ditore ose në institucione të tjera të specializuara për shërbimet rehabilituese;
  - e) rekomandon pajisjen e fëmijës me raportin mjeko-ligjor, kur fëmija nuk e ka.
7. Vlerësimi dhe praktika e punës së komisionit mbështetet në standardet ndërkombëtare të vlerësimit dhe funksionimit të aftësisë së kufizuar (standarde të Organizatës Botërore të Shëndetësisë).
8. Komisioni fton të paktën një prind gjatë vlerësimit të fëmijës dhe po të jetë e nevojshme, të afërm të tij. Kur fëmija është në kopsht/shkollë, përveç prindit marrin pjesë: punonjësi i shërbimit psiko-social në institucionin arsimor, mësues të fëmijës të caktuar nga drejtori i institucionit arsimor.
9. Komisioni rekomandon ndjekjen e shkollës së specializuar vetëm kur gjykon se ndjekja e një shkolle të zakonshme nuk do të zhvillonte sa duhet fëmijën me aftësi të kufizuara (AK).
10. Komisioni njofton me shkrim drejtorin e institucionit të zakonshëm arsimor se cilët nga fëmijët me AK do të mësojnë me plan mësimor dhe programe lëndore të zakonshme, të përshtatura ose individuale.
11. Komisioni pranë DAR/ZA-së udhëzon komisionet e institucioneve arsimore për punën me nxënësit me AK.
12. Komisioni mban dokumentacionin e gjendjes fillestare të fëmijës me AK dhe përditëson ecurinë e tij në bashkëpunim me komisionin në institucionin arsimor.
13. DAR/ZA-ja siguron kushtet e përshtatshme për ushtrimin e punës së komisionit.



administruar, rezultoi që nga ana e shkollës ka pasur vlerësim të rezultateve të këtij PEI, si dhe është hartuar PEI-t për vitin shkollor 2016-2017 dhe 2017-2018, i fundit mban datën 13.11.2017. Nga ana e shkollës u vu në dispozicion informacioni dhe provat, me anë të së cilave evidentohet se ka pasur vlerësim të rezultateve të PEI-it për nxënësin.

Gjithashtu, referuar parashikimit të nenit 65, pika 3, të ligjit nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, nxënësve me aftësi të kufizuara u sigurohen edhe mësues ndihmës dhe shërbim rehabilitues, sipas kritereve të përcaktuara<sup>4</sup> me udhëzim të ministrit, kjo për t’u siguruar një kujdes akoma edhe më të veçantë, si dhe për të ndihmuar në mbarëvajtjen e tyre në shkollë.

Në nenin 96, pika 2, gërma b) të Urdhërit të sipërpërmendur parashikohet si detyrë e drejtuesit të institucionit arsimor të zakonshëm të nxisë përmirësimin e jetës së nxënësve me AK në mjediset e insitucionit arsimor. Dispozita e mësipërme përcakton shprehimisht se Drejtuesi i institucionit arsimor është përgjegjës për marrjen e masave me karakter pozitiv në institucionin përkatës, për të luftuar diskriminimin në lidhje me të drejtën për arsimim. Këto masa përfshijnë edhe kërkesën drejtuar DAR Vlorë për mësues ndihmës.

Gjatë shqyrtimit të kësaj çështjeje, rezultoi se nxënësi ishte vlerësuar fillimisht nga Komisioni i shkollës për Vlerësimin e Fëmijëve me Aftësi të Kufizuara, e më pas nga Komisioni Multidisciplinar i DAR Vlorë, në mbështetje të kërkesave të dhe prindit.

Urdhëri nr. 343, datë 19.8.2013, i Ministrit të Arsimit dhe Shkencave “Për miratimin e dispozitave normative për sistemin arsimor parauniversitar”, në pikën 1 të Nenit 95, parashikon shprehimisht: “1. Drejtori i institucionit arsimor të zakonshëm ngre komisionin për nxënësit me AK, në përbërje të të cilit janë tre mësues të lëndëve të fushave të ndryshme të të nxënës dhe psikologu/punonjësi social.

Nga hetimet e kryera, rezultoi se nëpërmjet shkresës datë 13.09.2017, të Drejtorit të Shkollës 9-vjeçare “24 Maji”, Vlorë, pranë kësaj shkolle ishte ngritur një komision i tillë, i cili kishte filluar punën e tij menjëherë. Në këtë komision bën pjesë E.M, psikologe e shkollës, A.D, punonjëse

<sup>4</sup> 1. Sipas normës së përcaktuar nga ministri dhe vlerësimi nga komisioni pranë DAR/ZA-së, në klasat e zakonshme që kanë edhe fëmijë me AK, punojnë mësues ndihmës. Mësuesi ndihmës duhet të ketë diplomën e nivelit arsimor përkatës, të përcaktuar në nenin 57 të LAPU-s, dhe specializim të përshtatshëm në fushën e arsimimit të nxënësve me AK.

2. Mësuesi ndihmës, në bashkëpunim me mësuesin lëndor dhe prindin, hartojnë dhe venë në jetë PEI-në e fëmijës. PEI bazohet në dokumentet zyrtare të kurrikulës dhe përmban edhe objektiva për aftësitë e vetë-ndihmës dhe aftësi të tjera sociale, që nxënësi duhet të arrijë, sipas udhëzimeve të komisionit pranë DAR/ZA-së.

3. Mësuesi ndihmës shënon në planin ditari aspekte të ecurisë së fëmijës me AK.

4. Ndryshimi i PEI-t vendoset nga komisioni i institucionit në bashkëpunim me prindërit e fëmijës, pas propozimit të mësuesve ose prindërve.

5. Mësuesi ndihmës ose mësuesi kujdestar informon prindërit e fëmijëve me AK për shërbimet shtetërore shëndetësore rehabilituese që u ofrohen këtyre fëmijëve.

6. Pas marrjes së rekomandimit nga komisioni pranë DAR/ZA, prindërit vendosin nëse fëmija e tyre me AK do të ndjekë një institucion të specializuar ose të zakonshëm të arsimit bazë.

7. Prindërit mund të largojnë në çdo kohë nga shkolla fëmijën, kur gjykojnë se fëmija nuk përfiton nga mësimet ose ka mundësi të tjera më të mira.

8. Mësuesit dhe mësuesi ndihmës bashkëpunojnë me prindërit, në mënyrë që veprimtaritë, që zhvillohen në institucionin arsimor dhe në shtëpi të plotësojnë dhe të përforcojnë njëri-tjetrin.

sociale e shkollës dhe M.D, A.S, A.T, mësuese pranë Shkollës 9-vjeçare “24 Maji”, Vlorë. Ky komision ka miratuar planin edukativ individual për nxënësin L.M, plan i cili aktualisht zbatohet nga mësuesja e tij, E.Ç.

Për sa më sipër, gjykojmë dhe vlerësojmë se kërkesa e E.S, prindit të nxënësesit L.M, është plotësuar dhe djali i saj tashmë ka gjetur një mbështetje dhe ndihmë të kualifikuar, është përcaktuar mësuesja ndihmëse që nxënësi ka patur edhe në vitin shkollor 2016-2017, si dhe është përcaktuar një ambient i cili mund të përdoret nga nxënësja sa herë të lindi nevoja.

Sipas informacionit dhe provave të administruara, konstatohet se pasi ankuesja ka bërë prezent në Drejtorinë Arsimore Rajonale, Vlorë, në drejtorinë e shkollës “24 Maji” dhe pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, situatën e ndodhur ndaj djalit të saj, nga ana e këtyre institucioneve janë marrë masat, duke i caktuar mësuesen ndihmëse, E.Ç. Në përfundim të shqyrtimit të ankesës së paraqitur nga ana e E.S, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstaton se situata e pretenduar nga ankuesja është zgjidhur dhe nuk ekziston më.

Për sa më sipër, gjykojmë dhe vlerësojmë se kërkesa e E.S, është plotësuar dhe është arritur qëllimi për të cilin është iniciuar procedura hetimore.

### **PËR KËTO ARSYE :**

Mbështetur në nenin 1, 2, 7, 19, 32, pika 1, germa c), nenin 33, pika 10, të Ligjit nr.10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, nenit 63, pika 2, neni 64, pika 3, neni 65, pikat 2-3, të Ligjit nr. Nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, si dhe neneve 93-96 të Urdhërit nr. 343, datë 19.8.2013, të Ministrit të Arsimit dhe Shkencave “Për miratimin e dispozitave normative për sistemin arsimor parauniversitar”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

### **V E N D O S I :**

1. Pushimin e shqyrtimit të ankesës nr. 136, datë 24.10.2017, të E.S, kundër Drejtorisë Arsimore Rajonale, Vlorë dhe Shkollës 9-vjeçare “24 Maji” Vlorë, pasi është arritur qëllimi për të cilin është iniciuar procedura hetimore.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda afateve ligjore.

**Irma BARAKU**

**KOMISIONERI**